



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.09.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:39 dhe mbaroi në orën 11:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
6. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Mbledhja fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit e cila shprehet se mbledhja është lajmëruar ditën e djeshme për shkak të ngutshmërisë që kërkon trajtimi i çështjeve që do të shqyrtohen, kërkuar kjo nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Në rendin e ditës do të merret për shqyrtim një çështje e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet zotit Toska për më shumë detaje lidhur me relacionet.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska shprehet se ditën e sotme janë përgatitur trajtimi për kërkesat e disa gjykatave të apelit.

Por përpara se të fillohet me trajtimin e këtyre relacioneve, zoti Toska informon mbi një material i cili do i njoftohet edhe anëtarëve në rrugë elektronike pas përfundimit të mbledhjes. Nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, duke filluar nga muaji shkurt, deri në ditën e sotme, janë ende pa u trajtuar nga Këshilli 99 kërkesa për caktim gjyqtarësh në çështje gjyqësore të veçanta. Konkretisht në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë janë 28 kërkesa, nga të cilat 18 janë në lëndë civile dhe 10 në lëndë penale. Në Gjykatën e Apelit Vlorë janë 9 kërkesa, nga të cilat 4 në lëndë civile dhe 5 në lëndë penale. Në

¹ Procesverbal i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Gjykatën e Apelit Durrës janë 13 kërkesa, nga të cilat 8 në lëndë civile dhe 5 në lëndë penale. Në Gjykatën e Apelit Korçë janë 28 kërkesa, nga të cilat 13 janë në lëndë civile dhe 15 janë në lëndë penale. Në Gjykatën e Apelit Shkodër janë 19 kërkesa, nga të cilat 16 janë në lëndë civile dhe 3 janë në lëndë penale. Kurse në Gjykatën e Apelit Tiranë janë 2 kërkesa në lëndë civile.

Gjithashtu zoti Toska informon edhe për numrin e gjyqtarëve të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga 78 që duhet të jetë ky numër, aktualisht janë në detyrë vetëm 32 gjyqtarë, pra vetëm 41% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, çka e bën situatën në gjykatat e apelit shumë problematike, qoftë për gjykimin e çështjeve që ato kanë nevojë, qoftë sa i përket trajtimit të çështjeve të regjistruara përpara tyre.

Zoti Toska më tej propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht të hidhet shorti midis gjykatat e apeleve të juridiksionit të përgjithshëm, sipas kësaj radhe: Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Gjykata e Apelit Shkodër; Gjykata e Apelit Vlorë. Më tej shorti do të hidhet për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale, çështje të karakterit tepër urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, të caktuar më parë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, konkretisht Iliba Bezati, Sokol Ngresi dhe Nazmi Troka, dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Sokol Ngresi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore, në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i saj, konkretisht: z.Desart Avdulaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Desart Avdulaj.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Desart Avdulaj.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Izet Dushaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 1 në lëndë penale, me karakter “tepër urgjent” ose “urgjent”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 3 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 4.

Për 3 çështje, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: znj. Miranda Andoni.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Izet Salaj dhe Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarët Irena Brhimi dhe Izet Salaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale, me karakter “tepër urgjent” ose “urgjent”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 6. Gjyqtarët për 2 çështjet gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Propozimi vijues i Komisioni është:

Për 2 çështje, për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, të caktohen 6 të tillë, të cilët të përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart. Në këtë rast, një gjyqtar nuk mund të caktohet në më shumë se 1 çështje. Po ashtu, gjyqtarët Esmeralda Xhili dhe Rexhep Bekteshi nuk duhet të jenë relator në asnjë prej çështjeve, kjo nisur nga të dhënat, ku rezulton që këto dy gjyqtarë të jenë caktuar si relatorë për çështjet që Këshilli i ka ngarkuar nga shorti pranë gjykatave të posaçme.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Fillimisht shorti i bie zotit Rexhep Bekteshi si relator në çështjen e parë, ndaj ripërsëritet shorti.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Alma Kolgjoka (relatorë), Rexhep Bekteshi dhe Ornela Naqellari (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Manjola Xhaxho (relatore), Emona Muçi dhe Esmeralda Xhili (anëtarë).

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare

Naureda Llagami

Specialiste

Rosalba Xhabrahimi